



AKADEMIA "RRËNJËT TONA"

# KUVENDI IV NDËRKOMBËTAR

TRASHËGIMIA KULTURORE MATERIALE DHE SHPIRTËRORE E TRUNGUT  
PELLAZGO-EPIR-ILIR-ARBOR-SHQIPTAR NDËR SHEKUJ

## THIRRJE

*I nderuar Koleg i AKADEMISË RRËNJËT TONA,*

Së pari, ju urojmë një kalim sa më të shëndetshëm të situatës në botë dhe kudo në trevat shqiptare. Sigurisht, situatë jo e lehtë për njerëzimin, që mund të ndahet me humbje jo të vogla, por me shpresë më të madhe për të vazhduar më fort jetën.

Duke qenë se situata, do të kërkojë kohë, dhe të bërurit asgjë nuk do të jetë zgjidhje, në emër të grupit organizator do të bënim thirjen e rradhës për të vazhduar përpjekjen e përbashkët në organizimin dhe mbajtjen e Kuvendit të Katërt Ndërkombëtar, me temë: siç e keni bashkëngjitur këtë mesazhi.

Ky mesazh më poshtë po iu përcjillet personave që kanë botuar ose kanë shprehur interesin për të marrë pjesë në një Kuvend Ndërkombëtar, ku ju mund të gjeni, edhe qëllimin për të cilën po ju drejtohem.

Pasi kemi reflektuar nga disa sugjerime të ardhura, sot ndodhemi në gatitje për fillimin e një nisme që me plotëgjë, sëbashku mund të themi na qoftë udha e mbarë. AKADEMIA "RRËNJËT TONA", së bashku me një grup Shoqatash në Tiranë dhe një grup, jo i vogël individësh, kanë menduar të organizojnë këtë Kuvend të katërt Ndërkombëtar, mbi përpjekjet e popullit shqiptar për të ruajtur kulturën materiale dhe shpirtërore të trungut pellazg-ilir-arbnor-shqiptarë ndër shekuj e mijëveçarë.

Tipologjia dhe përmbajtja e veshjeve, këngëve, objekteve që ngjizën etnokulturën europiane deri më sot do jetë edhe periudha me pikë kulminante pazaret e Prizrenit, Beratit, Hasit, Shkodrës, Krujës, Janinës e më gjerë, ku do të përqendrohen studimet tona, për të cilat do të ndalet ky Kuvend, deri në mbajtjen e krijimit e të një ekspozite të plotë dhe enkas të kësaj etnokulture që ne gëzojmë sot.

Mbas shumë diskutimesh kemi arritur të përpilojmë një draft, me qëllimin dhe objektivat përkatëse. Pikërisht këtë po ju sjellim si fillim, ku do të donim fort:

1. Një vëmendje të caktuar nga ana e Juaj;
2. Të mendoni për një prurje, fillimisht për një përmbledhje (shqip & anglisht), si dhe për artikullin po në shqip dhe në anglisht, sipas afateve në dokumentin bashkëngjitur;
3. Të ndihmoni me kontakte të reja, jo vetëm me njerëz që kanë dëshirë, por edhe që kanë kontribute në lëmin e kerkuar (etnokulturë);
4. Duke qenë se është një 'projekt draft – qarkullor i parë informues', jemi të hapur për propozime nga ana Juaj, për Shoqata që dëshirojnë të jenë pjesëmarrëse në organizimin shkencor, grupin organizativ, si dhe për individë e grupe për mundësi mbështetje, me aq sa mundin.

*Lezhë / Prizren / Tiranë, 02-04 Mars 2022*

### **Shkurt, në këtë Kuvend do ketë:**

1. Një abstrakt gjysëm faqe shqip & anglisht,
2. Do ketë një artikull 10-12 faqe, anglisht dhe shqip, të një niveli akademik,
3. Prezantimi do të jetë shqip dhe anglisht, në rastin e pjesëmarrjes së ndonjë të huaji, por do të ketë përkthim direkt.
4. Do të ketë prezantim edhe me postera.
5. Do të ketë ekspozite me pavione me veshje dhe orendi të trashëgimisë etnokulturore për 12 Qarqe;
6. Do të ketë, si gjithmonë, veç ekspozitës dhe një Panair me libra tipikisht mbi etnokulturën.
7. Do të ketë libër abstrakesh, me një faqe për çdo artikull, shqip e anglisht.
8. Do të ketë libër Kongresi, me artikujt e autorëve, si një libër, "Booking Congress".

### **Mbani mend:**

1. Do të jetë Kuvend në nivelin më të lartë shkencor.
2. Do të mbahet për dy dite, me 5 Seanca nga 1 orë e 30 min secila, në Tiranë dhe në Prizren.
3. Do të ketë një grup të mirëfilltë etnologësh të organizuar sipas një Komisioni Shkencor, që do të bëjnë vlerësimet dhe pranimet e duhura të Referateve dhe Kumtesave.
4. Do të pranohen punime të arrira shkencërisht për të qenë pjesë e botimit me ISBN, dhe me faktor impakti të rreth 2,5-3,5.
5. Punimet që do të jenë të vetë përgatitura për botim sipas një modeli të një reviste shkencore nën logon e Akademisë "RRËNJËT TONA".
6. Afati për përmbledhjen në formë të shkurtuar (gjysëm faqe, 300 fjalë) sipas standardeve ndërkombëtare do të jetë 15 Tetor 2021.
7. Afati për artikullin e plotë, me 10-12 faqe në formën më të lartë akademike sipas standardeve ndërkombëtare do të jetë 15 Janar 2022.
8. Referatat do të mbahen nga 20 minuta plus 5 minuta pyetje e debat, dhe kumtesat do të mbahen nga 15 minuta plus 3 minuta pyetje.
9. Do të jepet mundësia që të marrin pjesë studiuesë, etnologë, studentë të etnografisë, me ftesa të personalizuar.
10. Të gjithë jeni të lutur që të mendoni apo të mendojmë për burime financiare të munshme me dashamirës ndaj përparimit të vlerave të kombit.
11. E fundit, do të donim fort dhe me këmbëngulje që të reagoni me përgjigjet tuaja, për pjesëmarrjen tuaj, për mbështetjen tuaj, për kontributin tuaj, për fjalën tuaj dhe për mendimin tuaj.

Në pritje të një përgjigjeje mundësisht pozitive, do donim t'Ju shprehim falenderimet e përzëmërta për bashkëpunimin Tuaj.

### **SEKRETARIA E KUVENDIT**

- |                           |  |
|---------------------------|--|
| 1. Prof.ing.av.Sazan GURI | Studiues, Drejtor Ekzekutiv i Kuvendit |
| 2. Kleha HAXHIASLLANI     | Sekretaria e Kuvendit                  |

### **GRUPI PUNËS**

- |                              |   |
|------------------------------|---|
| 1. Dr. Ing. Stefan PINGULI   | Studiues, President i Kuvendit                                  |
| 2. Prof. Dr. Afërdita ZENELI | Etnografe   |
| 3. Dr. Linda SPAHIU          | Etnokulturore   |
| 4. Dr. Luljeta DANO          | Etnologe  |
| 5. Fredi BALAJ               | Inxhinier dhe gjuhëtar, Sekretar i Akad. Rrënjët Tona           |
| 6. Prof. Dr. Nebi DERVISHI   | Filolog, Tetove, Pedagog në Univ Tetovës                        |
| 7. Dr. Neim DRAGA            | Studiues Filologji, Ulqin, antar i bordit të Akad. Rrënjët Tona |
| 8. Ibsen ELEZI               | Studiues i vlerave kombëtare.                                   |



**ILIRIKUM  
SANCRUM**

